

Deklarata e mbrojtjes së privatësisë kur do t'iu nënshtroheni provimit të gjuhës norvegjeze, provimit të njohurive shoqërore dhe / ose provimit të shtetësisë

1. Trajtimi i të dhënave personale kur t'iu nënshtroheni provimit të gjuhës norvegjeze, provimit të njohurive shoqërore dhe/ose provimit të shtetësisë

Kur regjistroheni për dhe/ose t'iu nënshtroheni provimit të gjuhës norvegjeze, provimit të njohurive shoqërore ose provimit të shtetësisë, ne trajtojmë të dhënat e juaja personale. Prandaj, më poshtë do të gjeni informacione se cilat të dhëna personale i trajtojmë, përse ne i trajtojmë të dhënat personale, dhe të drejtat tuaja në lidhje me trajtimin e të dhënave personale.

Drejtoria për Arsimin e lartë dhe kualifikim (HK-dir) është përgjegjëse për trajtimin e të dhënave. Kjo do të thotë që HK-dir është përgjegjës për mënyrën se si trajtohen të dhënat e juaja personale në HK-dir.

2. Pse i trajtojmë të dhënat personale për ju?

Ne trajtojmë informacione personale rreth jush, duke përfshirë informacione të ndjeshme personale, kur është e nevojshme për të kryer detyra në lidhje me qëllimin tonë. Qëllimi ynë është, t'u ofrojmë emigrantëve njohuri dhe aftësi për të qenë në gjendje të marrin pjesë në shoqërinë norvegjeze, si dhe të kryejnë provime për dokumentimin e njohurive të gjuhës norvegjeze dhe njohurive shoqërore.

Ne e bëjmë këtë në përputhje me nenin 6, numrin 1, (e) të GDPR dhe Ligjit të Integritimit § 41 (1) b) dhe/ose c), si dhe Rregulloren e integritimit § 54. Kur trajtohen të dhënat personale të ndjeshme, baza ligjore e trajtimit të informatave është GDPR neni 9 numri 2, nën shkronjën g) dhe Ligji i Integritimit § 41 (1) b) dhe/ose c). Kur t'iu nënshtroheni provimit, ne kemi të drejtën dhe detyrimin ligjor për të trajtuar të dhënat personale për ju, që shfaqen nga lista e mëposhtme.

Ne mbledhim dhe përdorim të dhënat tuaja personale për të kryer këto detyra:

- Sigurimi i cilësisë dhe organizimi i provimit të gjuhës norvegjeze, provimit të njohurive shoqërore dhe/ose provimit të shtetësisë
- Administrimi i provimeve në vendin e mbajtjes së provimeve
- Për të ruajtur të drejtën tuaj për t' u ankuar në vendim, që lejon të drejtën e ankesës
- Mbajtja e statistikave
- Hulumtime dhe analiza

Bazuar në Ligjin e Integritimit §41 (1) c) dhe Rregulloren e Integritimit § 64, vendimet e automatizuara përdoren për censurimin e provimit të leximit dhe dëgjimit në gjuhën norvegjeze, provimit të njohurive shoqërore dhe provimit të shtetësisë.

Këto tre provimet përbëhen nga pyetje me zgjedhje të shumëfishta, ku vetëm një alternativë është e saktë. Pragu i numrit të përgjigjeve të sakta për të kaluar provimin, si dhe se cilat përgjigje janë të sakta, janë paracaktuar dhe programuar paraprakisht në sistemin e provimit. Vlerësimi përfundimtar i kandidatit është një shumë e pikave bazuar vetëm në numrin e përgjigjeve të sakta, ku çdo përgjigje e saktë jep një pikë.

Vendimet e automatizuara nuk përdoren kur censurohen provimet me shkrim dhe me gojë në gjuhën norvegjeze, pasi këto provime vlerësohen nga ekzaminuesit fizikë dhe censorët.

Vendimet e automatizuara mund të monitorohen në mënyrë manuale nga Drejtoria për Arsimin e lartë dhe kualifikim. Nëse ka dyshim/rrethanë që tregon se mund të ketë ndodhur një gabim teknik ose ndonjë gabim tjetër, Drejtoria e Arsimit të lartë dhe kualifikimit, do të shqyrtojë në mënyrë manuale sistemin e provimit, dhe eventualisht rezultatin e provimit.

3. Nga i marrim informacionet personale?

Ne marrim informacionin personal si nga ju, po ashtu edhe nga autoritetet e tjera shtetërore. Këto autoritete shtetërore janë, për shembull:

- Drejtoria për Integrim dhe diversitet (IMDi)
- Komunat(Bashkitë)/vendet e mbajtjes së provimit
- Administratori shtetëror (në rastin e trajtimit të ankesave në shkallën e fundit)
- Drejtoria për të huajt (UDI)
- Ministria e punës dhe përfshirjes sociale
- Regjistri kombëtar i popullsisë

4. Çfarë informacioni personal për ju trajtojmë?

Ne mbledhim dhe trajtojmë këto informacione personale rreth jush:

- Emri
- Adresa
- Numri i telefonit
- Email /posta elektronike
- Data e lindjes
- Numri personal
- Numri DUF
- Numri D
- Numri i pasaportës
- Numri i kandidatit
- Gjinia
- Përgjigjet e provimeve
- Rezultati i provimit
- Lloji i provimit
- Koha kur i u jeni nënshtruar provimit

- Në cilën gjuhë është keni bërë provimin *
- Vendi i mbajtjes së provimit
- Ankesa
- Devijimet /mangësitë
- Kopjimi gjatë provimit

Ne gjithashtu trajtojmë informacionin personal në vijim, për kandidatët që janë regjistruar me këtë informacion para datës 15 shkurt 2022:

- Vendi i origjinës *
- gjuha amtare*

*Këto kategori informacionesh personale, konsiderohen këtu si informacione personale të ndjeshme.

5. Dorëzimi i të dhënave personale të tjerëve

Drejtoria për Arsimin e lartë dhe kualifikim nuk ua dorëzon të tjerëve të dhënat tuaja personale, përveç nëse ka bazë ligjore për dorëzimin e tyre. Shembuj të një baze të tillë do të ishte një bazë ligjore që na detyron të dorëzojmë informacionin.

Për ata me një numër personal, rezultatet e provimit dhe informacioni personal i lidhur me të, do të vihen në dispozicion përmes **Vitnemålsportalen** (Portalit të dëftësave/diplomave).

Shembuj të aktorëve që Drejtoria për Arsimin e lartë dhe kualifikim, ka një bazë ligjore për dorëzimin e të dhënave tuaja personale atyre janë:

- Drejtoria për Integrim dhe diversitet (IMDi)
- Komunitat(Bashkitë)/vendet e mbajtjes së provimit
- Administratori shtetëror (në rastin e trajtimit të ankesave në shkallën e fundit)
- Qendra e statistikave

- Drejtoria për të huajt (UDI)
- Ministria e punës dhe përfshirjes në shoqëri
- Institucionet e arsimit të lartë
- Sikt ¹

Drejtoria për Arsimin e lartë dhe kualifikim përdor trajtuesit e të dhënave për të mbledhur, ruajtur ose në një mënyrë tjetër të trajtoj të dhënat personale në emrin tonë. Në raste të tilla, ne kemi lidhur marrëveshje për të garantuar sigurinë e informacionit në të gjitha fazat e trajtimit. Ne përdorim këta trajtues të të dhënave në ditën e sotme:

- Enovate AS

I gjithë trajtimi i të dhënave personale që ne kryejmë, ndodhë brenda zonës së BE/ZEE (Bashkësisë Evropiane/Zona e bashkëpunimit ekonomik Evropian)

6. Koha e ruajtjes

Ne e ruajmë informacionin tuaj personal, për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimet e Ligjit të Integritimit § 41 paragrafi i parë. Rregullorja e Integritimit § 60 paragrafi i pestë thotë se, informacioni personal për personat që do t'iu nënshtrohen provimit mund të ruhen deri në 20 vjet, të llogaritura nga koha kur i' u është nënshtruar provimit. Prandaj, ne mund t'i ruajmë të dhënat tuaja personale deri në 20 vjet. Pas kësaj kohe, të dhënat tuaja personale do të fshihen.

Informacioni i mëposhtëm ruhet për një kohë të shkurtër:

- Adresa ruhet për 2 vjet
- Regjistrimet audio për pjesën e provimit në kuptimin e të lexuarit dhe komunikimin gojor në nivelin C1, ruhen për 1 vit
- Statusi i pagesës ruhet për 3 vjet
- Kopjimi për momentin dhe përfundimtar në provim, ruhet për 3 vjet

¹ [Vërejte e përkthyesit: Sikt është ofruar i shërbimeve për sektorin shkencorë dhe hulumtime shkencore]

7. Të drejtat tuaja kur ne trajtojmë informacione personale për ju

Ju keni të drejtë të kërkonti kontrollim dhe/ose korrigjim e të dhënave personale që ne trajtojmë për ju. Ju gjithashtu keni të drejtë në raste të caktuara, të kërkonti trajtim të kufizuar dhe të kundërshtoni trajtimin. Mund të lexoni më shumë rreth përmbajtjes së këtyre të drejtave në faqen e internetit të **Inspektoratit për mbikëqyrjen e të dhënave**.

Për të përdorur të drejtat tuaja, duhet të dërgoni një e-mail në **proveadministrasjon@hkdir.no** . Ne do t'ju përgjigjemi sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se 30 ditë.

Ne mund t'ju kërkojmë të konfirmoni identitetin tuaj ose të na jepni më shumë informacion, para se t'i përgjigjemi kërkesës tuaj. Ne e bëjmë këtë për t'u siguruar, që nuk i japim qasje në informacionet tuaja personale askujt tjetër përveç jush, dhe se nuk i japim informacionin tuaj personal askujt që pretendon se jeni ju.

8. Protektori i mbrojtjes së informatave personale

Drejtoria për Arsimin e lartë dhe kualifikim ka protektorin e vet të mbrojtjes së informatave personale. Protektori i mbrojtjes së informatave personale është **Torgeir Hovden** dhe mund të kontaktohet në e-mail adresën personvernombud@hkdir.no.

9. Ankesat

Nëse mendoni se trajtimi ynë i të dhënave personale nuk korrespondon me atë që kemi përshkruar këtu, ose që ne në mënyra të tjera shkelim legjislacionin e mbrojtjes së privatësisë, atëherë mund të ankoheni tek Inspektorati për mbikëqyrjen e të dhënave.

Mund të gjeni informacione se si të kontaktoni Inspektoratin për mbikëqyrjen e të dhënave, në faqen e internetit të **Inspektoratit për mbikëqyrjen e të dhënave**.

10. Ndryshimet

Nëse do të ndryshoj diçka në shërbimet tona, ose në rregulloret për trajtimin e të dhënave personale, kjo mund të çojë në ndryshime në informacionin që keni marrë këtu. Kjo deklaratë e mbrojtjes së privatësisë do të përditësohet dhe do të jetë në dispozicion në faqen tonë të internetit.

11. Informacioni për kontakt

Informacioni për kontaktin me Drejtorinë e Arsimit të lartë dhe kualifikim është:

Adresa: Fortunen 1, 5013 Bergen

Email: post@hkdir.nr

Telefoni: 55 30 38 00

Numri organizativ: 974788985

Nëse keni pyetje në lidhje me trajtimin tonë të informacionit tuaj personal, mund të dërgoni një e-mail në proveadministrasjon@hkdir.no.